



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 1176/Prot.
26

Tiranë më 04.5.2023

VENDIM

Nr. 28, datë 04.05 2023

“Për miratimin e ndryshimeve deri në masën 20%, të planeve mësimore të ciklit të parë dhe të dytë të studimeve, në Fakultetin e Shkencave Sociale, të UT-së, për vitin akademik 2023-2024”

Bazuar në ligjin Nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 3, pika 2, gërma “b”; neni 35, pika 9; neni 38, pika 1, gërma “dh”; Statutin e Universitetit të Tiranës, neni 31, gërma f; si dhe në propozimin e përcjellë nga Fakulteti i Shkencave Sociale me shkresat nr. 48/5 prot., datë 22.02.2023, nr. 48/7 prot., datë 20.03.2023, nr. 48/9 prot., datë 23.03.2023, nr. 48/11 prot., dhe nr. 48/13 prot., datë 25.04.2023, Senati Akademik i Universitetit të Tiranës në mbledhjen e datës 04.05.2023;

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin e Fakultetit të Shkencave Sociale për ndryshime deri në masën 20% në planet mësimore të programeve të ciklit të parë dhe të dytë të studimeve, për vitin akademik 2023-2024, në:
 - “Bachelor” në “Shkenca Politike”;
 - “Bachelor” në “Filozofi”;
 - “Master i Shkencave” në “Studime Rajonale Politike”;
 - “Master i Shkencave” në “Filozofi Sociale”;
 - “Master i Shkencave” në “Etika në Institucione dhe Lidërsip”;
 - “Master Profesional” në “Qeverisje dhe Politika Publike”;
2. Ky vendim i përcillet për njoftim Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Prof. Dr. Artan Hoxha

